


Statistikat Tregtare të Kosovës, Tregtia e jashtme e mallrave, eksporti-importi me Arabinë Saudite

Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), shkëmbimi tregtar me Arabinë Saudite¹, për vitin 2025 deficitin tregtar ka shënuar një përmirësim të lehtë prej 0.6% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak, duke u zvogëluar në -182.1 milionë euro nga -183.1 milionë euro sa ishte në 2024. Mbulueshmëria e importit nga eksporti është simbolike vetëm rreth 0.8%.

Figura 1. Bilanci tregtar i mallrave me Arabinë Saudite sipas viteve në milionë Euro



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

Tabela 1. Bilanci tregtar i mallrave në milionë euro, në % mbulueshmëria dhe rritje (v-m-v)

Viti	2022	2023	2024	2025
Eksport	1.8	1.1	1.5	1.5
Import	218.1	21.4	184.7	183.6
Bilanci tregtar	(216.3)	(20.3)	(183.1)	(182.1)
% e mbulimit	0.8%	5.0%	0.8%	0.8%
Rritje Exp. (v-m-v) %	92.8%	-39.6%	42.7%	-0.9%
Rritje Imp. (v-m-v) %	221.4%	-90.2%	764.4%	-0.6%
Bila. Treg. (v-m-v) %	223.2%	-90.6%	802.6%	-0.6%

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

¹ Arabia Saudite, zyrtarisht Mbretëria e Arabisë Saudite, është një vend në Azinë Perëndimore, në Gadishullin Arabik, me kryeqytet Rijadin. Ka një sipërfaqe prej 2,149,620 km², me rreth 34 milionë banorë. Bruto Prodhimi Vendor (GDP) nominal për vitin 2025 vlerësohet rreth 1.27 trilionë \$ (dollar amerikan), me të ardhura për kokë banori (per capita) rreth 35,464 \$ (dollar amerikan), e renditur si ekonomia e 19-të më e madhe në botë nominalisht sipas FMN-së.


Analizuar në periudhën e fundit marrëdhëniet tregtare të mallrave ndërmjet Kosovës dhe Arabinë Saudite karakterizohen nga një deficit i vazhdueshëm tregtar.

Gjatë kësaj periudhe eksportet e Kosovës drejt Arabisë Saudite janë simbolike me një mesatare vjetore rreth 1.5 milionë euro, gjatë vitit 2025 kemi një rënie për 0.9% apo rreth 0.01 milionë euro më pak krahasuar me vitin paraprak.

Ndërsa te importet vërejmë luhatje nga një pikë prej 218.1 milionë euro në vitin 2022, rënie e ndjeshme në 21.4 milionë euro (vitin 2023) dhe përseri ngritje në 184.7 milionë euro për vitin 2024 dhe 183.6 milionë euro për vitin 2025, gjatë vitit 2025 kemi një rënie të lehtë për 0.6% apo rreth 1.1 milionë euro më pak mallra te importuara krahasuar me vitin paraprak.

Importet nga Arabia Saudite (në sasi dhe në vlerë) dominojnë ndaj eksporteve të Kosovës, duke reflektuar varësinë të madhe të tregut kosovar nga këto produktet arabe. Si rezultat i këtij trendi vitet e fundit, përqindja e mbulimit të importeve me eksporte mbetet fare simbolik në vetëm rreth 0.8%.

Figura 2. Eksport/Importi me Arabinë Saudite sipas viteve në milionë Euro



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)


Gjatë vitit 2025 vlera e mallrave të eksportuara për në Arabinë Saudite ishin 1.52 milionë euro apo rreth 0.2% si pjesëmarrje në eksportin e përgjithshëm.

Importi i mallrave nga Arabia Saudite arritën në 183.6 milionë euro apo 2.6% si pjesëmarrje në importin e përgjithshëm, renditet e dhjeta në listën e 10 vendeve kryesore te importet.

Struktura e Eksportit/Importit me Arabinë Saudite në 2024 - 2025 sipas Sektorëve/grupeve të kapitujve

Te struktura e Eksportit për vitin 2025 grupet kryesore e përbëjnë: 71.4% Tekstil dhe artikuj tekstili; 27.7% Ushqimet e përgatitura, pije, pije alkoolike dhe duhani dhe 0.9% sektorëve/grupeve të kapitujve Tjera, si pjesëmarrje në eksportin e përgjithshëm me Arabinë Saudite.

Figura 3. Struktura e Eksportit 2024-2025 sipas Sektorëve/grupeve të kapitujve në %



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) dhe Open_DATA Doganat e Kosovës(DK)


Rënia e eksporteve për 0.9% apo rreth 0.01 milionë euro më pak mallra në vitin 2025 krahasuar me vitin paraprak, është ndikuar kryesisht nga rënia te sektori, Ushqimet e përgatitura, pije, pije alkoolike dhe duhani (nga 63.6% në 27.7%).

Eksportet e Kosovës drejt Arabisë Saudite karakterizohen nga një përqendrim i lartë, ku vetëm dy sektorët kryesorë si Tekstil e artikuj tekstili dhe Ushqimet e përgatitura (*si përgatitje të ndryshme të ngrënshme, kakao dhe përgatitjet prej kakaos*) përbëjnë rreth 94.6% në vitin 2024 dhe rreth 99.1% në vitin 2025 të vlerës totale të eksportuar.

Duke pasur parasysh se mbi 94% te eksporteve varen vetëm nga dy sektorë (tekstili dhe ushqimi), Kosova duhet të hulumtojë mundësitë për diversifikimin e gamës së produkteve drejt tregut saudit për të rritur stabilitetin tregtar. Rritja e pjesëmarrjes së sektorit të tekstilit në strukturën e eksportit nga 31.0% në 71.4% brenda një viti tregon një potencial të rëndësishëm që duhet të mbështetet me misionet tregtare dhe promovim të mëtijshëm.

Te analiza e Importit për vitin 2025, kemi një përqendrim i lartë të sektorëve-grupe kapitujve kryesorë si në vijim: 93.7% Produkte minerale; 5.5% Plastikë, gomë dhe artikuj prej tyre dhe 0.8% sektorëve/grupeve të kapitujve Tjera, si pjesëmarrje në importin e përgjithshëm nga Arabia Saudite.

Figura 4. Struktura e Importit 2024 - 2025 sipas Sektorëve/grupeve të kapitujve në %



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) dhe Open_DATA Doganat e Kosovës(DK)

Rënia e importeve për 0.6% apo rreth 1.1 milionë euro më pak mallra të importuara në vitin 2025 krahasuar me vitin paraprak, është ndikuar kryesisht nga rënia të sektori Produkte minerale (nga 95.8% në 93.7%).

Gjatë vitit 2025 nga gjithsej 868.42 milionë euro importe, të Kapitulli 27- *Lëndet djegëse minerale, vajrat minerale dhe produktet e destilimit prej tyre, substancat bituminoze, dyllët minerale*, vetëm nga Arabia Saudite janë importuar rreth 171.5 milionë euro apo rreth 20% të vlerës së përgjithshme të importuar të këtyre mallrave.

Dominimi i produkteve minerale me rreth 95.8% në vitin 2024 dhe rreth 93.7% në vitin 2025 të vlerës totale në strukturën e importeve, tregon varësinë e vazhdueshme të tregut dhe industrisë kosovare nga këto prodhime industriale dhe rithekson nevojën për diversifikimin e burimeve të furnizimit me lëndë të parë dhe energji, për të reduktuar ekspozimin ndaj një tregu në këtë sektor strategjik.